Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0134

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani-Kryetar,Vedat Poterqoi- Anëtar, Vjosa Gradinaj-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "Infinitt" sh.p.k., me seli në Prishtinë, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me klor gazët dhe hipoklorur natriumi" me numër të prokurimit 70433736-23-412-1-2-5, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)– Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina sh.a., më 13/06/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "Infinitt" sh.p.k me nr. 2023/0134, e datës 13/03/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me klor gazët dhe hipoklorur natriumi", me numër të prokurimit 70433736-23-412-1-2-5, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)-Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina sh.a.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 24.02.2023,në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues,për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimi me klor gazët dhe hipoklorur natriumi me nr. të prokurimit: 70433736-23-412-1-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina sh.a., ku është rekomanduar për kontratë OE "Seykos sh.p.k"

OE ankues "Infinitt" sh.p.k., me datën 01.03.2023, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 02.03.2023, AK - Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina sh.a., me vendim ka refuzuar

kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Infinitt" sh.p.k, me datën 13.03.2023,ka parashtruar,ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0134, kundër, njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 62,000.00€.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 19 mars 2023 me raportin e ekspertizës. AK Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina sh.a., ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq me datë 23 mars 2023 OE "Infinitt" sh.p.k., ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 19.03.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues "Infinitt" sh.p.k., sh.p.k me seli në Prishtinë, të refuzohet si e pa bazuar,

- të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 24.02.2023, (*vendim për dhënie të kontratës*). Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

<u>Përgjigje në pretendimet ankimore të OE Ankues</u>

<u>Përgjigje në pretendimi nr.1</u>

Pretendimi i OE ankues është si më poshtë:

Pretendimi ankimor i OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në dosjen e tenderit.

Kërkesa 2. Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me tenderin e tij, duhet të dëshmojë se në kuader të personelit të vet ka se paku një vozitës të licencuar për transportimin e mallrave(ngarkesave) të rrezikshme sipas ADR (European Agreement concerning the International Carriage of

Dangerous Goods by Road);Evidenca 2. -Kopja e Licences ADR per vozites (European Agreement concerning the International Carriage of Dangerous Goods by Road); -Kopja e Kontratës së Rregullt të Punës. Eksperti shqyrtues sqaron se Operatori Ekonomik ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tij si dëshmi ka një kontratë –marrëveshje angazhim për projekt e lidhur në mes të OE "Infinitt"sh.p.k. dhe z, Enver Jetullahu si vozitës. Kontrata – Marrëveshje e nënshkruar në mes të dy palëve është si më poshtë: Nga evidenca 2 e kërkuar në dosjen e tenderit Kopja e Kontratës se Rregullt të Punës dhe dokumentin të dorëzuar në oferte nga OE ankues kontratën – Marrëveshjen vërehet se te Neni 1 të kësaj kontrate –marrëveshje shënohet si me poshtë: Siç shihet më lart kjo dëshmi ka të bëjë me marrëveshje në mes te OE "Infinitt" dhe z Enver Jetullahu si vozitës dhe nuk ka të bëjë me kontrate të rregullt pune ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit ku kësaj kontrate- marrëveshje sipas Neni 4 kontratës –marrëveshjes ku theksohet " Ne rast se ne si OE "Infinitt" sh.p.k, arrimë të nënshkruajmë kontratën për projektin e lartcekur. I punësuari themelon marrëdhënie pune me orar jo të plotë (angazhuar).

Nga kjo shihet se OE ankues nuk ka plotësuar kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit duke ju referuar neni 4 të kontratës-marrëveshjes OE ankues nuk i ka plotësuar kriterin e kërkuar në dosjes e tenderit pasi që si dëshmi është kërkuar kontratë të rregullte të punës. Nga kjo Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin ofertave konformë nenit 59.4 të LPP-së, dhe me të drejte e ka eliminuar si ofertë e pa përgjegjshme.

Autoriteti kontraktues e ka vlerësuar ofertën e OE ankues konform nenit 59.4 të LPP-së citat " Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Me këtë OE ankues nuk e plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit ashtu siç janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit ka kërkuar decitivisht si dëshmi kontratë të rregulltë të punës dhe nuk ka kërkuar dëshmi si para kontratë apo marrëveshje për vozitësin dhe me të drejt e ka eliminuar OE ankues pasi që nuk i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit. Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Sa i për ketë nenit 60 Kriteret për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar Operatorin Ekonomik qe i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuar në dosjen e tenderit pasi që si kriter i dhënies ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. Me qenë se OE ankues edhe pse ka çmimin me te ulët se OE i rekomanduar mirëpo OE ankues nuk është ofertë e përgjegjshme pasi që nuk i plotëson të gjitha kriteret e kërkuar në dosjen e tenderit.Duke ju referuar nenit të sipër permendurë me lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Sa i për ketë nenit 69.8 të LPP-së që Operatori Ekonomik ankues ju është referuar për mendimin e ekspertit shqyrtues ky paragraf ka të bëjë kur kërkesat që nuk janë kërkuara në dosjen e tenderit ndërsa në këtë rast kërkesa/ kriteri është e specifikuar ne dosjen e tenderit dhe është obligative plotësimi i kritereve të kërkuara ne dosjen e tenderit. Duke ju referuar nenit të sipër permendurë me lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pa bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE"INFINITT" të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE ankues "Infinitt" sh.p.k, me seli në Prishtinë, të refuzohet si e pa bazuar dhe që të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 24.02.2023.

Lidhur me pretendimin e parashtruar nga OE ankues subjekt shqyrtimi i kësaj ankese përkundër eliminimit nga ky aktivitet prokurimi nga ana e AK-së, PSH konstaton se duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, konkretisht neni 59.4 i LPP-së parasheh citat *" Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Me këtë OE ankues nuk e plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit ashtu siç janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues*."

Në rastin konkret Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit ka kërkuar si në vijim:

Kërkesa 2. Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me tenderin e tij, duhet të dëshmojë se në kuader të personelit të vet ka se paku një vozitës të licencuar për transportimin e mallrave(ngarkesave) të rrezikshme sipas ADR (European Agreement concerning the International Carriage of Dangerous Goods by Road);Evidenca 2. -Kopja e Licences ADR per vozites (European Agreement concerning the International Carriage of Dangerous Goods by Road); -Kopja e Kontratës së Rregullt të Punës.

Lidhur me këtë kërkesë, OE ankues në ofertën e tij ka paraqitur një kontratë –marrëveshje angazhim për projekt e lidhur në mes të OE "Infinitt"sh.p.k. dhe z, Enver Jetullahu si vozitës, në përmbajtje të së cilës evidentohet se e njejta mbanë cilësine e parakontratës për këtë projekt për faktin se në kushtet e kontratës potencohet se "nëse OE ankues arrin të nënshkruajë kontratën për projektin e lartëcekur, I punësuari themelon marrëdhënie pune me orar jo të plotë (angazhuar)", andaj në këtë rast PSH konstaton se kriteri i referuar nuk është përmbushur për faktin që në të është kërkuar që i punësuari të jetë në kuadër të stafit me kontratë të rregullt të punës, andaj përfundimisht është arritur te klasifikimi i pretendimit ankimor si i pabazuar.

Përveç tjerash, vlen të potencohet se duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, i njejti parasheh periudhën kohore para ofertimit që palët e interesuara të ngrisin çështje sqaruese kundrejt AK-ve lidhje me DT dhe NJK, e poashtu palët e interesuara gjithmonë rezervojnë të drejtën e inicimit të procedurave ankimore (kërkesës për rishqyrtim, ankesës në OSHP) kundrejt kritereve eventualisht favorizuese, diskriminuese apo atyre të cilat mund të ngushtojnë konkurrencën, por këto veprime medoemos duhet të ndërmerren para ofertimit të OE pjesëmarrës, andaj PSH në

këtë rast poashtu ka konsideruar faktin që lidhur me këtë aktivitet prokurimi nuk janë evidentuar veprime të tilla të ndërrmarrura përgjatë periudhës së lartcekur, andaj PSH përfundimisht konstaton se AK ka eliminuar me të drejtë OE ankues për faktin se i njejti nuk ka përmbushur kërkesën e lartcekur.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**
- OE - **" INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: